



Znj. Manjola Doka

PËRGJEGJËSE E SEKTORIT TË MATJEVE ELEKTRIKE DHE TERMOMETRISË

Profili

Diplomuar si Inxhinierë Mjedisi në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, pranë Universiteti Politeknik i Tiranës në vitin 2003, si dhe është diplomuar në Inxhinieri Ndërtimi në të njëjtin fakultet në vitin 2014, me titull “Inxhinier Ndërtimi”.

Znj. Doka u punësua në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë në janar 2014 si specialiste në Laboratorin e Temperaturës, detyrë të cilën e ushtroi deri në shkurt 2024. Nga shkurti 2024 e deri më sot, ajo mban pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit të Matjeve Elektrike dhe Termometrisë.

Në kuadër të veprimtarisë së saj profesionale, Manjola Doka ka eksperiencë në fushën e kalibrimeve në temperaturë dhe matjeve elektrike, zhvillimin dhe përmirësimin e procedurave teknike, vlerësimin e pasigurisë së matjes dhe sigurimin e gjurmueshmërisë metrologjike në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e akreditimit.

Gjatë vitit 2022 ka realizuar me sukses katër ndërkrahime të zhvilluara në laboratorin e temperaturës. Prej vitit 2023 është person kontakti pranë Komitetit Teknik të Termometrisë në EURAMET, ku përfaqëson Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë në aktivitetet dhe bashkëpunimet teknike të kësaj organizate.

Gjithashtu, ka qenë pjesë e projekteve dhe aktiviteteve ndërkombëtare në fushën e metrologjisë, ndër të cilat:

- Projekti me nr. 2015.2066.7/FV-95266(C1), “Support of the Quality Infrastructure – Sectoral, National, Regional”;
- Pjesëmarrëse në ciklin e tetë të thirrjes TUBITAK – UME / BIPM, një program bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e metrologjisë që synon forcimin e kapaciteteve teknike të instituteve kombëtare të metrologjisë dhe laboratorëve referencë.

manjola.doka@dpm.gov.al